

URDHËR
Nr. 357, datë 29.7.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE SHITESË
PËR NJOHJEN E ORGANIZATAVE PRODHUESE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 62, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e kushteve shitesë për njohjen e organizatave prodhuese”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

RREGULLORE
**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE SHITESË PËR NJOHJEN E ORGANIZATAVE
PRODHUESE**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve shitesë për njohjen e organizatave prodhuese të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës sipas neneve 61 dhe 61/1 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe neneve 44/1-44/2 të ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, i ndryshuar.

Neni 2
Organizata prodhuese

Organizatë prodhuese nënkupton çdo organizatë prodhuese të peshkimit dhe akuakulturës që krijohet me nismën e prodhuesve sipas pikës 1, të nenit 61 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe nenit 44/1 të ligjit “Për akuakulturën”, të ndryshuar.

Neni 3
Njohja e organizatave prodhuese

Ministria mund të njohë si organizatë prodhuese çdo grup të krijuar me iniciativën e prodhuesve në sektorin e peshkimit ose akuakulturës, me kusht që:

a) të respektojë parimet e përmendura në nenin 4 të kësaj Rregulloreje dhe rregullat e miratuara për zbatimin e tyre;

b) të kryejë një veprimtari ekonomike të mjaftueshme, veçanërisht për sa i përket numrit të anëtarëve ose vëllimit të prodhimit të tregtueshëm;

c) të ketë seli qendrore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me personalitet juridik sipas legjislacionit në fuqi;

ç) të ndjekë objektivat përcaktuar në nenin 61/1, të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të nenit 44/2, të ligjit “Për akuakulturën” të ndryshuar;

d) të zbatojë rregullat në fuqi të konkurrencës;

dh) të mos abuzojë me pozitën dominuese në një treg të caktuar;

e) të sigurojë informacion të detajuar dhe të përshtatshëm në lidhje me anëtarët, administrimin dhe burimet e financimit.

Neni 4

Funksionimi i brendshëm i organizatave prodhuese

Funksionimi i brendshëm i organizatave prodhuese, bazohet në parimet e mëposhtme:

a) pajtueshmërinë nga anëtarët me rregullat e miratuara nga organizata në lidhje me shfrytëzimin, prodhimin dhe tregtimin të produkteve të peshkimit;

b) mosdiskriminimit ndërmjet anëtarëve, veçanërisht në lidhje me kombësinë ose vendin e themelimit;

c) vendosja e një kontributi financiar për anëtarët për financimin e organizatës;

ç) funksionimin demokratik që lejon anëtarët të kontrollojnë organizatën dhe vendimet e saj;

d) zbatimin e sanksioneve efektive, bindëse dhe proporcionale në rast mosrespektimi të detyrimeve të përcaktuara nga rregulloret e brendshme të organizatës, veçanërisht në rast të mospagesës së kontributeve financiare;

dh) përcaktimi i rregullave që kanë të bëjnë me pranimin e anëtarëve të rinj dhe përjashtimin e anëtarëve ekzistues;

e) përcaktimi i rregullave kontabël dhe buxhetore të nevojshme për menaxhimin e organizatës.

Neni 5

Procedura dhe forma e kërkesës për njohjen e organizatave prodhuese

1. Brenda tre muajve nga marrja e një kërkesë për njohje, Ministria informon me shkrim organizatën prodhuese për vendimin e saj. Në rast refuzimi, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

2. Informacioni që duhet të përfshihet në kërkesën për njohjen e organizatave prodhuese:

a) statuti i organizatës prodhuese, akti i themelimit, vendimi i gjykatës për regjistrimin dhe numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);

b) rregullat për funksionimin e brendshëm, sipas përcaktimeve të nenit 4 të kësaj Rregulloreje;

c) emrat e personave që mund të veprojnë në emër dhe për llogari të organizatës prodhuese;

ç) evidenca që organizata prodhuese zbaton kushtet e njohjes;

d) detajet e aktiviteteve të kryera prej saj, duke përfshirë fushën e veprimtarisë dhe produktet e peshkimit dhe akuakulturës për të cilat kërkohet njohja.

Neni 6

Kontrollet dhe tërheqja e njohjes

1. Ministria kryen kontrole në intervale të rregullta për të verifikuar nëse organizatat prodhuese janë në përputhje me kushtet e njohjes të parashikuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje, në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, të ndryshuar.

2. Mospërputhja me kushtet e njohjes sjell revokimin e saj.

Neni 7

Kushtet dhe procedura për revokimin e njohjes së organizatave prodhuese

1. Kur Ministria synon të revokojë njohjen e një organizate prodhuese, njofton organizatën për arsyet e revokimit.
2. Ministria i jep mundësinë organizatës në fjalë mundësinë për të paraqitur qëndrimin e saj brenda dy muajve nga marrja e njoftimit.

Neni 8

Komunikimi i vendimit

Ministria njofton vendimin mbi dhënien ose tërheqjen e njohjes brenda një periudhe tremujore nga marrja e tij.

Neni 9

Informacioni mbi çmimet kufi

Njoftimi i kryer nga Ministria mbi çmimet kufi që do të zbatohen nga organizata prodhuese duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) periudhën e zbatimit të çmimeve kufi;
- b) zonën ku do të zbatohen çmimet kufi;
- c) llojin e produktit peshkor që do t'i nënshtrohet vendosjes së çmimit kufi së bashku me kodin FAO alpha-3 për çdo specie;
- ç) çmimin kufi të vendosur për njësi peshe, sipas specieve;
- d) valutën e përdorur.